

RREGULLORE
Nr. 2, datë 3.8.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 1, DATË 7.3.2014,
“PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 64, DATË 31.5.2012, ‘PËR PESHKIMIN’”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 135, pika 2, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerr këtë rregullore.

Në rregulloren nr. 1, datë 7.3.2014, “Për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, ‘Për peshkimin’”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3, në shkronjën “a”, të pikës 1, dimensionimi minimal i zënies së ngjalës anguilla-anguilla bëhet 30 cm dhe nga viti 2024 bëhet 35 cm.

Neni 2

Në nenin 4, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“Gjuhca (cironka) – *Alburnus albidus alborella* prej 20 prillit deri më 20 korrik në liqenin e Ohrit dhe 1 prill deri më 31 korrik në zonat e tjera ujore.”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, si më poshtë vijon:

“1/1. Ndalohet peshkimi me rrjeta në distancë prej 300 m nga bregu në liqenin e Ohrit dhe në liqenin e Shkodrës dhe 150 m nga bregu për zonat e tjera ujore. Periudha e ndalimit është 20 korrik deri më 20 gusht për liqenin e Ohrit dhe 1 gusht deri më 31 gusht për zonat e tjera ujore.

Peshkimi i gjuhçës (cironkës), në liqenin e Ohrit bëhet vetëm me tratë zalli (vlagë) me madhësi syze të thesit jo më të vogël se 12 mm. Çdo dalje në liqen për gjueti gjuhçë me këtë lloj trate monitorohet nga Inspektorati i Peshkimit dhe OMP-ja”.

3. Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“Krapin – *Cyprinus carpio* 1 muaj në vit, sipas urdhrit të ministrit, brenda periudhës 20 prill deri më 20 korrik në liqenin e Ohrit dhe 1 prill deri më 1 korrik në zonat e tjera ujore.”.

4. Pika 16, riformulohet:

“16. Ndalohet hedhja e çfarëdolloj rrjete peshkimi deri në izobatën prej 10 m për detin Adriatik dhe deri në izobatën prej 20 m për detin Jon”.

5. Pas pikës 17 shtohen pikat 18 dhe 19, me këtë përmbajtje:

“18. Ndalohet peshkimi me rrjeta zhytëse fundore në liqenin e Ohrit, në largësinë mbi 1300 m nga bregu.

19. Në peshkimin tregtar artizanal në bregdet, veglat e peshkimit (mbrezhda, njica, kurthe, grepa etj.) hidhen/lëshohen në mbrëmje, në përfundim të diellit dhe ngrihen në mëngjes, në lindje të diellit, sipas orareve të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Muaji	Lindja e diellit	Perëndimi i diellit
Janar	07:00	16:40
Shkurt	06:40	17:15
Mars	06:00	17:45
Prill	05:10	18:15
Maj	04:15	18:50
Qershor	04:50	19:10
Korrik	04:15	19:10
Gusht	04:50	18:40
Shtator	05:15	17:45
Tetor	06:00	17:15
Nëntor	06:30	16:30
Dhjetor	07:00	16:15

Ndalohet lënia e veglave të mësipërme të peshkimit fikse gjatë periudhës tjetër të ditës.”.

Neni 3

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 6, riformulohet si më poshtë:

“6. Ndalohet përdorimi i njicave pelagjike (driftnets) në të gjitha ujërat e brendshme dhe në ato detare.”.

2. Pika 7, shfuqizohet.

3. Pas pikës 10, shtohen pikat 11 dhe 12 me këtë përmbajtje:

“11. Ndalohet përdorimi i më shumë se 1000 m rrjetë peshkimi (ngjica dhe mrezhda), si dhe përdorimi i më shumë se 200 grepave peshkimi, në peshkimin tregtar artizanal me mjete lundruese pa kuvertë në ujëra bregdetare.

12. Ndalohet të përdoren për peshkim profesional mjetet lundruese të tipit motoskafe ose gomone ose i mjeteve ku raporti fuqi motorike kw/peshë GT është më i madh se 50.”.

Neni 4

Në nenin 8, pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“4. Lejohet instalimi i vetëm tre stanikëve në bregdetin shqiptar në distancë jo më pak se 200 m nga bregu:

a) një stavnik në gjirin e Shëngjinit, i baraslarguar nga grykëderdhja e Drinit të Vjetër dhe grykëderdhja e lagunës së Merxhanit;

b) një stavnik në gjirin e lagunës së Patokut në veri të grykëderdhjes së lumit Mat, duke respektuar distancën nga grykëderdhja e lumit në det;

c) një stavnik në jug të Kepit të Rodonit.

5. Në liqenin e Ohrit, ndalohet peshkimi me mbi 150 grepa/për çdo grup peshkimi, si dhe përdorimi i mjeteve motorike në varkat e peshkimit me fuqi motorike mbi 15 kw.”.

Neni 5

Neni 33, ndryshohet si më poshtë:

“1. Vlefshmëria e lejes së peshkimit tregtar ka një kohëzgjatje 10-vjeçare, e cila tregohet qartë në leje. Me mbarimin e afatit të vlefshmërisë së lejes së peshkimit, leja e peshkimit rinovohet automatikisht me dorëzimin e kërkesës përkatëse të pronarit të anijes së peshkimit.

2. Përjashtimisht, kur anija e peshkimit jepet me qira/huapërdorje nga pronari i saj, leja e peshkimit ka vlefshmëri sipas afatit të kontratës së lidhur, por në çdo rast jo më shumë se 10 vjet. Me mbarimin e afatit të kontratës, leja e anijes së peshkimit rinovohet nga përdoruesi i ri, sipas pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 6

Në nenin 37, pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Numri maksimal i lejeve të peshkimit tregtar artizanal përcaktohet nga ministri, në zbatim të planit të menaxhimit të peshkimit dhe të planit të zbatimit të peshkimit.”.

Neni 7

Neni 55, riformulohet si më poshtë:

“Neni 55

Inspektorët e peshkimit, sa herë kryejnë inspektime, duhet të mbajnë me vete dhe të plotësojnë *online* dokumentacionin, sipas modelit të miratuar me urdhër të Inspektoratit Qendror.”.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Roland Kristo